

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi i Komunës së Graçanicës në mbledhjen e tretë të jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 26.05.2026, merr këtë:

VENDIM NR.27/2026/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 28.04.2026

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 28.04.2026.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 28.04.2026.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.


Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 28.04.2026 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 18 nga 19 këshilltarë dhe ka kuorum, ndërsa mungon këshilltari Millosh Dimiq. Në mbledhje janë të pranishëm: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, mediat, Shërbimi për Informim, Shërbimi për Përkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi këshilltarët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e dytë e jashtëzakonshme e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti e dha njëzëri mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit tha se në bazë të nenit 44 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 është caktuar rendi i mëposhtëm i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 01.04.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (*Novak Živić*).
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për dhënien e autorizimit kryetarit të komunës për fillimin e konsultimeve dhe hartimine propozim-marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (*Milan Dimitrijević*).
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar për vitin 2026, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (*Slaviša Ničić*).
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për periudhën prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq (*Aleksandra Đekić*).

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Goran Milliq (**Goran Milić**).

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (**Bogić Đurović**).

8. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (**Bogić Đurović**).

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për lirim të Shoqatës së guetarëve “Graçanica” nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e vendgjuetisë për një periudhë prej 12 muajsh, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (**Bogić Đurović**).

10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 01.04.2026.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq (**Novak Živić**).

Kryesuesi shpjegoi se nisma për bashkëpunim ndërkomunal i referohet Komunës së Graçanicës dhe Komunës së Zubin Potokut si dhe në mbledhjen e mëparshme kur miratuar bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Leposaviqit. Kuvendi i Komunës së Zubin Potokut miratoi Vendimin me të cilin i dha pëlqimin kryetarit të komunës për ta filluar procedurën për lidhjen e një marrëveshjeje për bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Graçanicës, në bazë të të cilit Zyra e kryetarit të Komunës së Zubin Potokut ia përcolli kërkesën kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 16 këshilltarëve “Pro” dhe 2 vota “Kundër” të Nikolla Rashiqit dhe Ivanës Vojoviqit, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për dhënien e autorizimit kryetarit të komunës për fillimin e konsultimeve dhe hartimine propozim-marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal, me propozim të kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq (**Milan Dimitrijević**).

Kryesuesi shpjegoi se pas miratimit të pikës së mëparshme, është e nevojshme të merret vendimi për ta autorizuar kryetarin e komunës që t'i fillojë konsultimet dhe ta hartojë propozimin për marrëveshjen mbi bashkëpunimin ndërkomunal.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 12 këshilltarëve "Pro", dy vota "Kundër" të Nikolla Rashiqit dhe Ivanës Vojoviq, 4 vota "Abstenim" të Bekim Gashit, Aidës Qerkini, Lumnijës Gashi dhe Albert Vllahiut, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit tremujor financiar për vitin 2026, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq (*Slaviša Ničić*).

Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se për tre muajt e mbuluar nga raporti, janë shpenzuar 2,182,777.14 euro ose 17.34% e buxhetit të përgjithshëm ose 32.34% e mjeteve të alokuara për tre muajt. Për tre muajt, të hyrat vetanake janë realizuar në një shumë prej 428,113.16 euro ose 15.10% e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2026.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve "Pro", miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për periudhën prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekić (*Aleksandra Đekić*).

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekić, e paraqiti raportin për periudhën e lartcekur. Në raport është theksuar se në librin e protokollit të shkurtuar janë regjistruar 864 lëndë; Shërbimi i Lejeve Ndërtimore ka dhënë përgjigje ndaj 749 kërkesave të përpunuara; Shërbimi i Lejeve Ndërtimore ka realizuar të hyra në një shumë prej 746,235.56 euro, ndërsa janë përpunuar gjithsej 84 lëndë lidhur me procesin e legalizimit. Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka lëshuar 41 leje mjedisore dhe ka realizuar të hyra në një shumë prej 73.663,23 euro, ndërsa Shërbimi i Banimit gjithashtu ka punuar në mënyrë aktive dhe ka dal në terren. Në vazhdim, drejtoresha Gjekić i lexoi nga raporti projektet kapitale të zbatuara në vitin 2025.

Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë "Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë", tha se Komuna e Graçanicës realizoi të hyra në një shumë prej 746,235.56 euro nga lëshimi i lejeve ndërtimore dhe e pyeti drejtoreshën nëse e dinë se sa kishte humbur komuna për shkak të "lulëzimit" të ndërtimeve të paligjshme.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se drejtoria i zbaton vetëm procedurat për marrjen e lejeve ndërtimore, përkatësisht kushteve në mënyrë që një projekt të ndërtohet.

Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë “Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë”, tha se kishte parë në media se Komuna e Prishtinës kishte shembur disa objekte që nuk kishin leje ndërtimore. Ai pyeti se çfarë e pengon Komunën e Graçanicës të veprojë në mënyrë të ngjashme.

Kryesuesi u përgjigj se në mandatin e mëparshëm kishin shumë objekte të tilla sa që Ministria e Infrastrukturës i ndryshoi vendimet e Komunës së Graçanicës për ndërtimin e objekteve, duke theksuar disa dispozita ligjore në bazë të të cilave ua ka lëshuar lejet ndërtimore. Komuna ngriti tre kallëzime penale kundër Komisionit të Ministrisë, i cili dha leje për tre objekte dhe këto leje janë në kundërshtim me Planin urban të komunës, të cilin e ka përcaktuar vetë ministria.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se Drejtoria e Urbanizmit nuk mund ta parandalojë ndërtimin në terren, dhe sa i përket dokumentacionit, ajo që kemi hasur që nga fillimi i këtij viti është një trend ku qytetarët tanë dërgojnë ankesa në ministri, bazuar në vendimet e refuzuara që marrin nga Drejtoria e Urbanizmit, edhe pse parcelat e tyre ndodhen jashtë zonës së ndërtimit të parashikuar nga Plani zhvillimor, por e njëjta ministri miraton që ata mund të ndërtojnë. Rasti i parë është një projekt për 11 shtëpi në Çagllavicë, ku gjykata e pranoi vendimin e Komunës së Graçanicës dhe u vendos një masë e përkohshme, ndërsa Gjykata e Apelit gjithashtu pranoi vendimin e asaj gjykate. Rasti i dytë është për panelet diellore dhe është ende në Gjykatën e Apelit, si dhe për një objekt bujqësor, një depo prej 2000 m².

Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë “Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë”, tha se Komuna e Graçanicës shpenzoi 921,295.00 € për rinovimin e rrugëve në vitin 2025. Ai pyeti pse pas gjashtë muajsh shfaqen gropa në rrugë, siç janë rrugët në rrugën Gushterica e Poshtme - Badovc dhe në Llapllasellë nga spitali deri te stadiumi. A është iniciuar kontrolli i cilësisë?

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se kontrolli është inicuar, sepse të gjithë kontraktorët gjatë paraqitjes së tenderit dhe nënshkrimit të kontratës i kishin të gjitha licencat e kërkuara për t'u përfshirë në tender. Seksionet rrugore që i përmendët u ndërtuan gjatë sezonit të shirave të dimrit të keq dhe meqenëse garancia e performancës është ende e vlefshme, menaxheri i projektit do ta kontaktojë kontraktorin për t'i riparuar rrugët.

Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë “Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë”, pyeti pse, pas punimeve në rrjetin e kanalizimeve, ajo pjesë thjesht mbushet dhe nuk kthehet në gjendjen e saj origjinale.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjeki, u përgjigj se sipas kontratës, Kompania e Ujësjellësit, e cila operon rrjetin e furnizimit me ujë, duhet ta riparojë atë, por ata nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, tha se beson që projekti: “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe ndërhyrje të ndryshme në Komunën e Graçanicës”, i cili iu dha një kompanie private për periudhën korrik 2025 deri në korrik 2028 për një shumë prej 1,172,455.00 €, duhej t’i ishte dhënë Nëdrmarjes publike-komunale “Ekologjia”, pasi që edhe ajo i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara.

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, Vlladica Trajković, tha se kanë pasur një takim me drejtorin e përgjithshëm të Ujësjellësit dhe se janë pajtuar, meqenëse nuk kanë mjete sipas kontratës për riparimin e sipërfaqeve të asfaltit dhe shtigjeve për këmbësorë, që komuna ta bëjë këtë dhe që Ujësjellësi t’ia paguajë ato fatura komunës. Tenderi që u shpall për prokurim publik vitin e kaluar u vonua në nënshkrimin e kontratës, për shkak se pati ankesa, dhe më pas në mbledhjen e Kuvendit, u miratua Aneksi 3, ku ato pozicione iu dhanë përkohësisht Ekologji-së deri në përfundimin e procedurës së tenderit. Pasi përfundoi procedura e tenderit, u nënshkrua kontrata me kompaninë që ishte më e lira në tender, ndërsa Ekologjia nuk mori pjesë në tender, por sigurisht Ekologjia nuk ka kamionë bore dhe mekanizimin e nevojshëm dhe nuk ka referenca për ato punime.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, bëri një vërejtje se raporti nga menaxheri i projektit është i mangët dhe se fjalitë përsëriten në disa vende. Gjithashtu thuhet se rruga midis Graçanicës dhe Llapllasellës është larë në periudhën tetor-dhjetor, gjë që ai nuk e ka vënë re.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, paraqiti problemin se lagjja e NIC-së nuk ka trotuare dhe se kubat në rrugë janë dëmtuar nga kompanitë që i përdorin kamionët e rëndë gjatë ndërtimit të objekteve në zonë. Ajo pyeti nëse komuna ka ndonjë plan për t’i riparuar ato rrugë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjeki, u përgjigj se ata kanë problem me shkatërrimin e infrastrukturës rrugore në të gjithë territorin e Komunës së Graçanicës nga kamionët me tonazh të madh se i lejuari. Meqenëse vendbanimi NIC ka një problem të madh me ujërat e zeza, ajo propozoi që ky problem të zgjidhet së pari dhe më pas të shtrohen rrugët. Ajo i tha këshilltares Qerkini se qytetarët e atij vendbanimi duhet patjetër të paraqesin një kërkesë.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se vendbanimit NIC i mungon një park dhe një kënd lojërash për fëmijë. Ajo pastaj e tregoi një fotografi të një parcele komunale që do të ishte e përshtatshme për këtë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se së pari duhet ta kenë pëlqimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për shfrytëzimin e hapësirave publike.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, gjithashtu e paraqiti problemin e ndriçimit rrugor në vendbanimin NIC, ku është e nevojshme të zëvendësohen vetëm dritat shumë të vjetra.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se duhet të paraqitet një kërkesë në mënyrë që shërbimet komunale të mund ta zëvendësojnë ndriçimin rrugor.

Kryesuesi kishte një vërejtje lidhur me raportin, sepse në të nuk kishte fotografi dhe gjithashtu ish-drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Goran Milliq, përmendet në pothuajse të gjitha projektet si menaxher i projekteve. A është kjo rastësi apo Drejtoria e Urbanizmit ka disa zyrtarë të tjerë që mund të jenë menaxherë të projekteve. Nga përvoja personale, e di që disa projekte nuk i ka monitoruar mirë. A është lidhur uji i qytetit me fshatin Batushë?

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, Vlladica Trajković, u përgjigj se kjo është faza e parë e rrjetit të furnizimit me ujë që u ndërtua nga Lepina në Batushë dhe tani po presim që inxhinierët e furnizimit me ujë të kontrollojnë nëse do të lidhen me ato tuba apo nëse do të na duhet të ndërtojmë një rrjet të ri.

Kryesuesi pyeti: “Kush e bënë matjen e sipërfaqes e objekteve në magjistrallë kur bëhet pranimi?”. Do t’i pyesja se kur kanë dalë për herë të fundit në terren dhe kanë matur objekte të sapondërtuara, sepse mendoj se komuna mbledh 3-4 herë më pak taksa.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Alleksandra Gjekiq, u përgjigj se Shërbimi Komunal i Tatimit i bënë matjet e objekteve.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 17 këshilltarëve “Pro” dhe një votë “Abstenim” të Dejan Bozhidareviqit, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Goran Milliq (*Goran Milić*).

Kryesuesi i njoftoi këshilltarët se pika numër 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente për vitin 2025 do të shpjegohet nga drejtori i Administratës, Vlladica Trajković, i cili ishte drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike për pjesën më të madhe të vitit 2025, ndërsa pika do të hapet nga drejtori i sapoemëruar i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Marko Arsiq, i cili e zëvendësoi Goran Milliçin.

Marko Arsiq, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, tha se është emëruar si drejtor i Shërbimeve Publike një javë më parë, kështu që raportin do ta paraqesë drejtori Trajković.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse Ekologjia mund t’i lajë rrugët një herë në muaj në vend që komuna ta ndajë një shumë të madhe për një kompani për tre vjet.

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, Vlladica Trajković, u përgjigj se projekti quhet “Pastrimi, larja e rrugëve dhe trotuareve, mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve dhe ndërhyrje të ndryshme në Komunën e Graçanicës”. Në bazë të kërkesave, Ekologjia ka bërë larjen e rrugëve, por këtu kemi edhe furnizimin me kripë, pastrimin e kanaleve dhe pozicione të tjera që i kemi me kontratë. Mjetet nuk janë shpenzuar për larjen e rrugëve, sepse në periudhën e dimrit përparësi është mirëmbajtja e rrugëve me lartësi. Komuna, së bashku me Ekologjinë, ka blerë një autocisternë, kështu që pozicioni për larjen e rrugëve i mbeti Ekologjisë.

Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë “Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë”, pyeti pse shënimi i sinjalistikës horizontale dhe vertikale po zgjat kaq shumë dhe gjithashtu pse nuk ka vendkalim të shënuar për këmbësorë pranë shkollës në fshatin Dobrotin.

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, Vlladica Trajković, u përgjigj se duhet të bëhet dallimi midis rrugëve lokale dhe atyre magjistrale. Rruga magjistrale që kalon nëpër Graçanicë drejt Gjilanit dhe rruga nga Janjeva në Lipjan është rrugë magjistrale dhe është nën juridiksionin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe komuna duhet t’u dërgojë atyre një kërkesë për vendosjen e tabelave dhe shënimin e vendkalimeve për këmbësorë. Javën e ardhshme e kemi caktuar një takim me drejtorin e Ministrisë së Infrastrukturës, ku do të këmbëngulim për shënimin më cilësor të rrugëve në këto drejtime.

Këshilltari i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Albert Vllahu, para partisë “Aleanca Shqiptare”, e paraqiti problemin me derdhjen e ujërave të zeza në tokën bujqësore nga Çagllavica deri te Prishtina Mall-i. Një peticion për zgjidhjen e këtij problemi është paraqitur nga banorët e Suhadollit më 26.07.2025, por asgjë nuk është bërë lidhur me këtë.

Drejtori i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Çështjeve Kadrovike, Vlladica Trajković, u përgjigj se Komuna e Graçanicës ka kontaktuar disa herë Ministrinë e Infrastrukturës, sepse rruga magjistrale nga Preoci, Llapllasella deri te rrethrotullimi te QMI” dhe në drejtim drejt Lipjanit është zgjeruar, ku në të dyja anët e rrugës kemi rrjetin e ujërave të zeza, kanalizimit dhe atmosferik dhe të gjitha gypat drejtohen drejt Lipjanit dhe pika më e ulët

është kanali që kalon nëpër Suhadoll. Ne kemi aplikuar në Ministri për tre vjet rresht me një projekt të përbashkët me Komunën e Lipjanit, por nuk kemi marrë përgjigje pozitive. Bazuar në kërkesën tuaj, ajo që mund të bënim ishte pastrimi i kanalit nga hekurudha drejt Sitnicës, 1600 metra i gjatë. Zgjidhja e këtij problemi kërkon mjete të mëdha që Komuna nuk i ka, kështu që do të kërkohet ndihmë nga donatorët.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se kur do të zgjidhet problemi i lidhjes së tre shtëpive rrome në Graçanicë me sistemin e kanalizimit, i cili derdhet në kanalet e shiut.

Marko Arsiq, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, u përgjigj se pas mbledhjes, ata mund të shkojnë së bashku në terren për të parë se si mund të zgjidhet problemi.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për periudhën prej 01.01.2025 deri më 31.12.2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (**Bogić Đurović**).

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, tha se në bashkëpunim me organizatën “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (KADI)”, ishin pjesë e projektit “Fuqizimi i Komuniteteve Rurale përmes Zhvillimit Bujqësor”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim (SIDA). Mjetet e projektit menaxhohen nga Këshilli Danez për Refugjatët, ku nëntë anëtarë të komuniteteve jo-shumicë nga territori i Komunës së Graçanicës morën makineri dhe pajisje bujqësore. Duke vazhduar prezantimin e tij, drejtori Bogiq Gjuroviq lexoi nga raporti se në cilat panaire, seminare dhe trajnime morën pjesë. Në kuadër të drejtorisë gjithashtu operon Shërbimi i këshillimit, ku të gjithë fermerët mund të drejtohen për këshilla.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, tha se raporti nuk përfshin numrin e njerëzve që morën grante, as nuk përfshin informata mbi ripyllëzimin.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se drejtorja vetëm mbledh dokumente dhe ia dorëzon ato Ministrisë. Sa i përket pyllëzimit, ai është transferuar në nivelin qendror.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 17 këshilltarëve “Pro”, dhe një votë “Abstënim” të Dejan Bozhidareviqit miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2025, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (**Bogić Đurović**).

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, tha se subvencionet nga Ministria kishin dy konkurse, përkatësisht: Konkursi i parë nga 15.01.2025 deri më 15.02.2025, ku fermerët e blegtorisë nga territori i komunës kanë mundur të aplikojnë për subvencione të qumështit, pra sasinë e qumështit të shitur. Fillimi i konkursit për subvencione bujqësore për zhvillimin e prodhimit bujqësor filloi më 03.04.2025 dhe konkursi ishte i hapur deri më 02.05.2025. Për shkak të problemeve teknike, konkursi u zgjat deri më 19.05.2025. Kishte dukshëm më shumë fermerë të regjistruar në konkurs krahasuar me vitin e kaluar, kështu që këtë vit patëm gjithsej 800 aplikantë për mbi 5.000 ha tokë të punueshme. Subvencionet kishin të bënin me: kulturat (grurë, misër, elb, etj.), dosat, lopët qumështore, dhinë dhe delet, bletët (bletët e mjaltit), frutikulturën, perimet dhe vreshtat. Në pjesën e dytë, punuam për ndihmën përmes pagesave për qumësht/litër, sasinë e grurit të dorëzuar, etj. Afati i fundit për aplikim ishte nga 01.08.2025 deri më 01.09.2025 dhe në atë konkurs patëm 400 aplikantë me mbi 7500 ton për të cilat ata justifikuan grurin e shitur, pra kokrra gruri, dhe patëm shumë pak aplikantë për qumësht. Kur bëhet fjalë për subvencionet që Drejtoria e Bujqësisë ndan çdo vit në përputhje me buxhetin për promovimin dhe zhvillimin e bujqësisë, shpallet një thirrje publike për mbështetje financiare për financimin e programeve të OJQ-ve për zhvillimin e bujqësisë. Thirrja u shpall më 29.08.2025 dhe bazuar në vetë procedurën e thirrjes, një subvencion në vlerë prej 20,000 € iu dha OJQ-së “Qendra për Afirmimin Rinor, Graçanicë”, e cila këtë vit punoi në bashkëpunim me Shoqatën e grave “Duart e Arta të Graçanicës”, me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve nga Plani i Veprimit për Barazi Gjinore të Komunës së Graçanicës. Bazuar në këtë projekt, u dhanë: 11 kultivues, 8 serra, u mbajtën disa trajnime dhe ligjërata, 1,500 € u dhanë strehimores për qen dhe vaj për fermerët.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti drejtorin nëse kishte informacion se sa aplikantë morën subvencione, nga 800 aplikantë për bujqësi etj., si dhe 400 aplikantë për drithëra të shitur.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se të gjithë aplikantët i morën ato, por kjo nuk është përfshirë në raport sepse nuk kanë të dhëna zyrtare. Duke pasur parasysh që ministria është vonuar me një pjesë të caktuar të pagesave këtë vit, disa fermerëve ende nuk u janë paguar subvencionet.

Këshilltari Dejan Bozhidareviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti a është strehimorja e qenve nën juridiksionin e Komunës së Graçanicës.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se strehimorja e qenve është e një organizate joqeveritare, por komuna ndan mjete të caktuara çdo vit si ndihmë. Strehimorja e qenve është mjaft e vogël dhe kemi informacion se qentë sillen nga komuna të tjera dhe lirohen në komunën tonë.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se edhe vendbanimi NIC ka problem me qentë endacakë dhe ajo ka informacion se një grua vendase e ka paditur komunën për shkak të kafshimit nga qentë endacakë. Ajo pyeti nëse planifikohet të bëhet diçka për zgjidhjen e këtij problemi.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigjën se kishin planifikuar ta rrisnin buxhetin e strehimoren, në mënyrë që ata të jenë më aktivë në terren, por jo të gjithë qentë në rrugë mund të vendosen në strehimore.

Këshilltari i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Albert Vllahu, para partisë “Aleanca Shqiptare”, tha se ka informata se shumica e komunave në Kosovë ndajnë mjete për fermerët nga 5 deri në 8 centë për litër qumësht. Lidhur me këtë, ai ka përgatitur një kërkesë që do t’ia dërgojë Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe nëse është e mundur, edhe Komuna e Graçanicës të ndajë mjete për fermerët për qumësht.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se deri më tani Ministria i ka paguar fermerët për litër duke u bazuar në sasinë e qumështit të shitur, sepse drejtorja nuk e ka buxhetin e vet.

Këshilltari Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, kërkoj nga drejtori që të interesohet se si është zhvilluar rrjeti i strehimoreve për qen në komuna të tjera.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, u përgjigj se drejtorja do të kontaktojë Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe do të shihet me ta se si do të zgjidhet ky problem.

Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të vendimit për lirim të Shoqatës së gjuetarëve “Graçanica” nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e vendgjuetisë për një periudhë prej 12 muajsh, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq (*Bogić Đurović*).

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Bogiq Gjuroviq, tha se Shoqëria e gjuetarëve “Graçanica” është drejtuar me kërkesë për lirim nga pagesa e qirasë për shfrytëzimin e vendgjuetisë për një periudhë prej 12 muajsh. Shoqëria e gjuetarëve financohet ekskluzivisht nga taksat e anëtarësimit të gjuetarëve dhe është gjithashtu e përfshirë në mbrojtjen dhe ruajtjen e florës dhe faunës në territorin e Komunës së Graçanicës, gjë që kërkon shpenzime të caktuara.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e nëntë të rendit të ditës.



Kryesuesi i Kuvendit hapi pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Të ndryshme.


Këshilltari Nikolla Rashiq, para partisë “Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë”, tha se Komuna e Graçanicës ka shpallur konkurs për punë praktike, ku thuhej se afati do të zgjaste deri në plotësimin e 55 vendeve të lira. Meqenëse konkursi përfundoi dje, ai pyeti a do të pranohen 55 njerëz që kanë aplikuar për herë të parë për punë praktike apo ka pasur ndonjë kriter dhe kërkoj qasje në çfarë kohe kanë aplikuar njerëzit.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 12:32.

Procesmbajtësi
Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës



Milan Dimitrijević